REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

# Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.07.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, loti I-rë dhe III-të", me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1**, nxjerr:

## VENDIM

I. **Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik **Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k** e dt.06.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, loti I-rë, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, dhe** Nr. Brendshëm **632-21-003-511**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 07.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

II. **Aprovohrt** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik **Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k** e dt.06.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, loti III-të, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, dhe** Nr. Brendshëm **632-21-003-511**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 07.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së

**2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES për Lotin e I-rë, e publikuar me datë: 07.06.2021;**

**3. Anulohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES për Lotin e III-të, e publikuar me datë: 07.06.2021;**

4. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit **për Lotin e I-rë;**

5. . Autoriteti Kontraktues, vendos që të kthejë në Ri-vlerësim aktivitetin e prokurimit **për Lotin e III-të.**

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k, ka parashtruar** kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, loti I-rë dhe III-të", me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, dhe** Nr. Brendshëm **632-21-003-511.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 14.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Për pretendimet ankimore për lotin e I-rë:

- Në lidhje me pretendimin ankimor se Operatori Ekonomik "Drini Company"i ka paraqitur të gjitha sigurimet e tenderit fals, Autoriteti kopntraktues sqaron se një pretendim i tillë nuk qëndron sepse Operatori në fjalë i ka sjellë kopjet fizike të sigurimit të tenderit të cilat kanë numrin serik të njejtë me ato të ngarkuara në platformë

Serial 0600301118002

PRISIG
KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

# DEKLARATA E GARANTUESIT
## Sigurim Tenderi

Për **KOMUNA E GJAKOVËS**
(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PATUR PARASYSH SE **SH. DRINI COMPANY SH.P.K.**
(emri i operatorit ekonomik, më tej "Tenderuesi")

Ka marrë përsipër të depozitojë sigurinë e tenderit që i referohet Dosjes së Tenderit, me Titill **NDERTIMI-ASFALTIMI I RRUGEVE NE KOMUNEN E GJAKOVES PJESA-I-re LOT-1**, Nr. i Prokurimit: **632-21-574-5-1-1** e dërguar nga Autoriteti Kontraktues:
(Nr.i referencës së Prokrimit)

DUKE PATUR PARASYSH SE Tenderuesi dëshiron të depozitojë një garanci për shumën e specifikuar në Dosjen e Tenderit:

DUKE PATUR PARASYSH SE jemi pajtuar që Tenderuesit t'i japim një garanci të tillë:
PRANDAJ NE nëpërmjet kësaj konfirmojmë se ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj jush në emër të Tenderuesit, deri në totalin prej: **€ 2,500.00**

**Dy mije dhe Pes qinde €**
(Shuma e garancesë me shifra dhe me fjalë)

dhe ne marrim përsipër t'ju paguajmë, pas kërkesës së juaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet se tenderuesi është në mungesë për shkak se:

- Autoriteti Kontraktues ka vendosur, duke u bazuar në fakte objektivisht të verifikuara se Tenderuesi ka dhënë Autoritetit Kontraktues informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese; ose
- Tenderuesi ka tërhequr tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; ose
- Tenderuesit i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe Tenderuesi pastaj refuzon ose dështon:

1. që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në Dosjen e
2. që të përmbush çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në Dosjen e Tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose
3. të nënshkruajë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në Dosjen e Tenderit;

dhe pa ankim ose pa argument, çdo shume ose shumat brenda limitive **€ 2,500.00**
për të cilat u fol, pa pasur nevojë që ju të dëshmoni ose të demonstroni bazën ose arsyet e kërkesës së juaj ose ndaj shumës së specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës **05.05.2021** deri më **01.09.2021**

Lëshuar në **PRIZREN** datë **05.05.2021**

**Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve**

**PRIZREN**

0008310

PRISIG

KOMPANIA E SIGURIMEVE · INSURANCE COMPANY

# DEKLARATA E GARANTUESIT
## Sigurim Tenderi

Seria\ 0600301118005

Për **KOMUNA E GJAKOVËS**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PATUR PARASYSH SE **SH. DRINI COMPANY SH.P.K.**

(emri i operatorit ekonomik, më tej "Tenderuesi")

Ka marrë përsipër të depozitojë sigurinë e tenderit që i referohet Dosjes së Tenderit, me Titill **NDERTIMI-ASFALTIMI I RRUGEVE NE KOMUNEN E GJAKOVES PJESA-I-re LOT-2**, Nr. i Prokurimit: **632-21-574-5-1-1** e dërguar nga Autoriteti Kontraktues:

(Nr.i referencës së Prokrimit)

DUKE PATUR PARASYSH SE Tenderuesi dëshiron të depozitojë një garanci për shumën e specifikuar në Dosjen e Tenderit;

DUKE PATUR PARASYSH SE jemi pajtuar që Tenderuesit t'i japim një garanci të tillë:
PRANDAJ NE nëpërmjet kësaj konfirmojmë se ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj jush në emër të Tenderuesit, deri në totalin prej: **€ 2,000.00**

**Dy mije €**

(Shuma e garancesë me shifra dhe me fjalë)

dhe ne marrim përsipër t'ju paguajmë, pas kërkeses se juaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet se tenderuesi është në mungesë për shkak se:

- Autoriteti Kontraktues ka vendosur, duke u bazuar në fakte objektivisht të verifikuara se Tenderuesi ka dhënë Autoritetit Kontraktues informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese; ose
- Tenderuesi ka tërhequr tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; ose
- Tenderuesit i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe Tenderuesi pastaj refuzon ose dështon:

  1. që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në Dosjen e
  2. që të përmbush çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në Dosjen e Tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose
  3. të nënshkruajë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në Dosjen e Tenderit;

dhe pa ankim ose pa argument, çdo shume ose shumat brenda limitve **€ 2,000.00**
për të cilat u fol, pa pasur nevojë që ju të dëshmoni ose të demonstroni bazën ose arsyet e kërkesës së juaj ose ndaj shumës së specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës **05.05.2021** deri më **01.09.2021**

Lëshuar në **PRIZREN** datë **05.05.2021**

**Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve**

**PRIZREN**

0008309

PRISIG

KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

# DEKLARATA E GARANTUESIT
## Sigurim Tenderi

Serial\ 0600301118009

Për **KOMUNA E GJAKOVËS**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

**DUKE PATUR PARASYSH SE** **SH. DRINI COMPANY SH.P.K.**

(emri i operatorit ekonomik, më tej "Tenderuesi")

Ka marrë përsipër të depozitojë sigurinë e tenderit që i referohet Dosjes së Tenderit, me Titill **NDERTIMI-ASFALTIMI I RRUGEVE NE KOMUNEN E GJAKOVES PJESA-I-ra LOT-4**, Nr. i Prokurimit: **632-21-574-5-1-1** e dërguar nga Autoriteti Kontraktues:

(Nr.i referencës së Prokrimit)

DUKE PATUR PARASYSH SE Tenderuesi dëshiron të depozitojë një garanci për shumën e specifikuar në Dosjen e Tenderit;

DUKE PATUR PARASYSH SE jemi pajtuar që Tenderuesit t'i japim një garanci të titlë:
PRANDAJ NE nëpërmjet kësaj konfirmojmë se ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj jush në emër të Tenderuesit, deri në totalin prej: **€ 2,000.00**

**Dy mije €**

(Shuma e garancesë me shifra dhe me fjalë)

dhe ne marrim përsipër t'ju paguajmë, pas kërkesës së juaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet se tenderuesi është në mungesë për shkak se:

- Autoriteti Kontraktues ka vendosur, duke u bazuar në fakte objektivisht të verifikuara se Tenderuesi ka dhënë Autoritetit Kontraktues informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese; ose
- Tenderuesi ka tërhequr tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; ose
- Tenderuesit i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe Tenderuesi pastaj refuzon ose dështon:

1. që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në Dosjen e
2. që të përmbush çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në Dosjen e Tenderit, para nëshkrimit të kontratës përkatëse, ose
3. të nënshkruajë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në Dosjen e Tenderit;

dhe pa ankim ose pa argument, çdo shumë ose shumat brenda limitive **€ 2,000.00**
për të cilat u fol, pa pasur nevojë që ju të dëshmoni ose të demonstroni bazën ose arsyet e kërkesës së juaj ose ndaj shumës së specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës **05.05.2021** deri më **01.09.2021**

Lëshuar në **PRIZREN** datë **05.05.2021**

**Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve**

**PRIZREN**

0008308

- Sa i përket Vërtetimeve të Gjykatës,ATK-së dhe Tatimit në pronë, Operatori në fjalë këto vërtetime i ka ngarkuar në platformë dhe i ka sjell kopjet fizike;

-Pretendimi juaj që ka të bëj me deklaratën nën betim, është i pa bazuar sepse shtimi i emrit të aktivitetit dhe nr.prokurimit në Dekleratën nën betim nuk përbën shkelje por është vetëm devijim minor neni 59 pika 4 e LPP-së:

> ***4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.***

-Sa i përket pretendimit tuaj se çmimet e paraqitura në ofertën e operatorit në fjalë janë çmime abnormalisht të ulëta, sqarojmë se Autoriteti kontraktues nuk i ka konsideruar si të tilla;

- Pretendimi juaj se operatori në fjalë nuk ka arritur të dëshmoj se ka staf të mjaftueshëm për kryerjen e punimeve i mungojnë dy inxhiniera të gjeodezisë, Autoriteti kontraktues sqaron se nuk është kërkuar inxhinier i gjeodezisë <u>por thjeshtë gjeodet</u>:

" LOT-I-rë , LOT-II-të , LOT-IV-rë Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 15 (pesmdhjetë) punëtorë staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit a.) ) inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - (menaxher i kontratës dhe projektit në teren) me 5 vjet provoj pune pas diplomimit. b.) 1. inxhinier i diplomuar apo master i komunikacionit me 5 vjet provoj pune pas diplomimit c.) **<u>2. gjeodet (permanent në teren) me 5 vjet provoj pune pas diplomimit "</u>**

- Pretendimi tjetër i juaj lidhur me sigurimet e tenderit nuk qëndron, sepse nuk janë kërkuar sqarime shtesë për sigurimet por vetëm është kërkuar të sillen origjinalet:

**Besim Haxhija**

| | |
|---|---|
| **From:** | Besim Haxhija |
| **Sent:** | Thursday, June 17, 2021 11:57 AM |
| **To:** | 'driniasphalt@yahoo.com' |
| **Cc:** | Faton Gutaj |
| **Subject:** | kerkes |
| **Attachments:** | KERKES-SH.DRINI..docx |

Në attach e gjeni kërkesën e ber nga AK-ja

Me respekt
Besim Haxhija
Zyra e Prokurimit
KK Gjakove

Kerkes

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës me datë 28.05.2021 ka bër kerekës për sjelljen e këtyre dokumenteve si në vijim:

Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës, Vërtetim nga Gjykata kompetente, Sigurimi i Tenderit

- Vërtetimi nga Komuna që Operatori Ekonomik nuk ka obligime në tatim në pronë – origjinali.

Ju si Operator Ekonomik i keni prezantuar të gjitha vërtetimet por sigurimin e tenderit nuk na keni sjellur origjinalin ,dhe keni kërkua nga AK-ja te ju bëj te mundur sjelljen e sigurimit te tenderit ditën kur do të nënshkruhet kontrata se edhe ashtu sigurimi është e ngarkuar në platëformen e e-prokurimit .

Ju duhet te sjellini polica e sigurimit, kopje fizike të njëjtat të cilat janë ngarkuara në platformën e e-prokurimit.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet **të pranohen deri me 18.06.2021 në ora 16:00.**

<u>Për pretendimet ankimore për lotin e III-të:</u>

-Në lidhje me pretendimin ankimor se Grupi i Operatorëve ekonomik "Marisa" shp.k. & "Company Murseli" sh.p.k., nuk i kanë dorëzuar Vërtetimet e Gjykatës, ATK-së dhe Tatimit në pronë, Autoriteti kopntraktues sqaron se një pretendim i tillë nuk qëndron sepse Grupi i Operatorëve në fjalë, këto dokumente i ka ngarkuar në platformë dhe i ka sjell kopjet fizike;

Për pretendimin tuaj se pas kërkesës suaj për rishqyrtim , Autoriteti kontraktues prap ka kërkuar dokumente nga operatorët ekonomik, sqarojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar sipas **Nenit 72 të LPP-së:**

1. ***Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.***

2. ***Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.***

**dhe nenit 39 të RRUOPP:**

*39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate.*

*39.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE.*

- Pretendimi juaj që ka të bëj me deklaratën nën betim, është i pa bazuar sepse shtimi i emrit të aktivitetit dhe nr.prokurimit në Dekleratën nën betim nuk përbën shkelje por është vetëm devijim minor neni 59 pika 4 e LPP-së:

> ***4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.***

-Për pretendimin tuaj se konzorciumi në fjalë nuk ka arritur të dëshmojë që ka punëtorë të mjaftueshëm dhe nuk ka arritur të paraqet kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT, Autoriteti kontraktues sqaron se dokumentet në fjalë janë kërkuar me Kërkesë për sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, të cilat dokumente konzorciumi në fjalë i ka ngarkuar në platformë.

-Pretendimi juaj se konzorciumit në fjalë i mungon marrëveshja me kompanin Gërlica për makineri është pjesërisht i bazuar, sepse është prezantuar marrëveshja vetëm për një RUL

-Për pretendimin tuaj se Grupi i Operatorëve ekonomik "Marisa" shp.k. & "Company Murseli" sh.p.k., ka paraqitur referenca të Operatorit Ekonomik "Viktory Com", Autoriteti Kontraktues sqaron se një gjë e tillë është bërë duke u bazuar në nenet 68 paragrafi 4 dhe neni 69 paragrafi 8 i LPP-së:

Paragrafi 4 i nenit 68 të LPP-së në lidhje me **gjendjen ekonomike dhe financiare,** përcakton:

4. *"Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera".*

Paragrafi 8 i nenit 69 të LPP-së në lidhje me **aftësitë teknike dhe/ose profesionale,** përcakton:

8. *"Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera".*

Në kuptim të dispozitave të lartë cituara, kurdo që Autoriteti Kontraktues ushtron aktivitetin e prokurimit për të dhënë **një kontratë të veçantë,** dy apo më shumë Operator Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **MUND** të mbështeten në kapacitetet financiare, teknike dhe/ose profesionale të të njëjtit Operator Ekonomik *(marrëveshje për mbështetje financiare, marrëveshje për shfrytëzim të pajisjeve apo marrëveshje me të njëjtin inxhinier),* ngase në këtë rast vetëm një Operator Ekonomik që plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe të dhënies, ka për të fituar kontratën.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivit të Komunë